



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2360/prot.
8

Elbasan, më 02.11.2021

VENDIM

Nr. 45 datë 02 .11.2021

"PËR
RIORGANIZIMIN E DY NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE"

Në mbështetje të nenit 30 pika 6, nenit 38 gërma "ë" të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 gërma "f", nenit 9 gërma "k" të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", me propozim të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Humane, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Në Fakultetin e Shkencave Humane, njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane" dhe njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge" riorganizohen në një njësi bazë të emërtuar "Departamenti i Gjuhëve të Huaja".
2. Në Fakultetin e Shkencave Humane mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane".
3. Në Fakultetin e Shkencave Humane mbyllet njësia bazë e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge".
4. Njësia bazë e re e emërtuar "Departamenti i Gjuhëve të Huaja" do të jetë përgjegjëse për programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Gjuhëve Angleze dhe Gjermane dhe Departamenti i Gjuhëve Italiane dhe Frënge.
5. Dokumentacioni i Departamentit të Gjuhëve Angleze dhe Gjermane dhe Departamentit të Gjuhëve Italiane dhe Frënge do të administrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.
6. Ngarkohet Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim t'i përcillet Senatit Akademik për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ardian DURMISHI

